



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivry | 23.12.2022 | 2 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHUK | 8422/2022 | | 1/3 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1081/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1081/2022 të datës 01.12.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Bedri Gjinaj" Mitrovicë, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1081/2022 e datës 01.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 01.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 7527/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohjen e të drejtës për harmonizim të koeficientit të pagës nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 05.12.2022 ka



proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa, kjo e fundit më datë 08.12.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7527/2022 të datës 29.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimit me numër të protokollit 01-112.22552 të datës 27.08.2013; Kartela e identifikimit në punë e ankuesit; Përgjigjeni në ankesë me numër 01-120/04-0105454-2/22 të datës 25.11.2022 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 7657/2022 e datës 05.12.2022; Përgjigjeni në kërkesë me numër të protokollit 7805/2022 të datës 08.12.2022 nga Komuna e Mitrovicës së Jugut; Përshkrimi i detyrave të punës e datës 05.08.2019; Kërkesë për harmonizim të koeficientit të pagës e datës 15.11.2022 e parashtruar nga ankuesi tek Shefi i Personelit; Përgjigjeni në kërkesë e datës 16.11.2022; Lista e pagave për muajin shtator, tetor dhe nëntor 2022; Konkurs me RN00009989i datës 23.09.2022 për pozitë Inspektor i Shërbimeve Publike; Emailin e datës 10.11.2022 dhe 20.12.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësishëm të shqyrtimit administrativ, konstatoi se është e bazuar ankesa e ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, gjegjësisht sipas Akt Emërimit me numër të protokollit 01-112.22552 të datës 27.08.2013, në pozitën "*Inspektor i komunikacionit*" në Drejtorinë e Inspektionit, me koeficient gjashtë (6) të pagës. Tutje ankuesi me datën 15.11.2022 ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 01-120/04-0102687/22 tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut për harmonizim (ngritje) të koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), ndërsa Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës përmes përgjigjes në kërkesë me 01-120/04-0105454-2/22 të datës 25.11.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesit për harmonizim të koeficientit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, pretendon se në kuptim të legjislacionit në fuqi të bëjë harmonizimin e koeficientit nga koeficienti aktual gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "*Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*", si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: "*Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë*". Andaj, mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesi është emëruar në pozitën e *Inspektor i komunikacionit* me koeficient gjashtë (6) të pagës klasa profesional 1, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 19.08.2022 dhe 20.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar se pozita inspektor-klasa profesionale 1, ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Rrjedhimisht Kolegji, konstaton se mos realizimi i pagesë së njëjtë për punë të njëjtë paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues në raport me ankuesin ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: "Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve në kuptim të së drejtës së pagesë është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..." Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu që bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit konstaton së në ketë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e tërësishëm të ankesës së ankuesit duke i dhënë të drejtë ankuesit për rregullimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6), në tetë (8), për pozitën e punës Inspektor i komunikacionit.

Andaj, theksuar si me sipër, obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit ankuesit nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8).


Siç u theksua me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1081/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

